

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut me Nr. 2001/35, mbi Pensionet në Kosovë, të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 1 mbi definimin e Pensionit me Benefit të Definuar dhe Pensionet me Kontribut të Definuar në Nenin 14.7 të Rregullores së UNMIK-ut me Nr.2002/35, (“Rregullorja e Pensionit”),

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës (BPK), në mbledhjen e tij të mbajtur më 23 tetor 2002 miraton si vijon:

## **Rregulla 17 mbi Vlerën e Benefiteve të Pensionit e aplikueshme për Fondin e Pensionit Suplementar Pundhënës**

### **Neni 1**

#### **Sfera dhe qëllimi i Rregullës**

##### **1.1 Sfera e Rregullës**

Kjo Rregull i adresohet Fondit të Pensionit Pundhënës Suplementar (“Fondi i Pensionit”).

##### **1.2 Qëllimi i Rregullës**

Kjo Rregull themelon disa direktiva për determinimin e benefitit dhe shumës(ave) që mundë të sigurohen sipas programit Pundhënës Suplementar të Pensionit. Këto direktiva sigurojnë dhe ndihmojnë se rregullimi pensional është i mështetur, me mundësi të dhënjes dhe sipas standardeve të barabarta dhe të paanshme të shpërndarjes së benefiteve të pensionit, veqanrisht gjatë viteve formuese kur pensionet janë të njohura dhe të zhvilluara në Kosovë.

### **Neni 2**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

##### **2.1 Definimi**

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq do të definohen më tutje në këtë Rregull.

“Supozimet aktuariale” i referohen një numri të vlersimeve që janë shfrytzuar për të llogaritur kontributet për të përcaktuar benefitet e pensionit në rregullimin Pensional me Benefit të Definuar. Kjo ka të bëjë me zhvillimet e ardhshme që do të ndikojnë në financimin e benefiteve të pensionit dhe faktorëve, në mes tjerash, shkalla e interesit, shkalla e mortalitetit, shkalla e invaliditetit, shkalla e përfundimit, shkalla e ngritjes së rrogave ose ndryshime tjera ekonomike.

“Shërbimet e kredituara” ose “shërbimi i fituar”, nënkupton numrin e viteve të shërbimit që pjesmarrsi ka arritur për të Drejtat e tij /asaj të Rezervuara.

“Pensioni invalidor” i referohet pranueshmërisë për të filluar benefitet e pensionit para moshës 65 vjeqare për pjesmarrësit të cilët vuajnë kualifikimin invalidor të definuar nga SRSG ose me ligj ose statut që i jepa asaj/atij të drejtën për të pranuar pension, ose duhet të definohet në Urdhëresën e Pensionit.

“Pensioni i shtyer” nënkupton benefitin e pensionit që rezervohet për pjesmarrsin në përfundimin e marrëdhënjes së punës së asaj/atij që paraqitet para moshës së pensionit mirpo për të cilën fillimi i pensionit shtyhet derisa ajo/ai arrin moshën e pensionit.

“Benefiti i hershëm i Pensionit” nënkupton dispozitën në Urdhëresën e Pensionit që lejon pjesmarrsin i cili pensionohet para moshës së pensionit të filloj pensioni e tij apo asaj. Një benefit i hershëm i pensionit mundë të filloj pas moshës së hershme 60 vjeqare ose 35 vitesh shërbim.

“Fitimet” nënkupton pagën vjetore totale ose të ardhurat e rrogës të një individi siq është definuar nga ligjet e aplikueshme mbi taksat në të ardhura në fuqi në Kosovë.

“Moshë e Pensionit” nënkupton moshën 65 vjeqare, dhe “benefit normal të pensionit” nënkupton pensionin për pjesmarrësin që fillon pasi ajo apo ai arrin moshën e pensionit.

“Fitimi i bazës së Pensionit” nënkupton fitimin pse pjesën e fitimit të pjesmarrësit, vlera e të cilës mund të definohet në Urdhëresën e Pensionit, të shfrytzuar si bazë për llogaritjen e vlerës së kontributeve të pensioneve dhe benefiteve.

### **Neni 3**

#### **Benefitet e Pensionit të Fondit të Pensionit**

##### **3.1 Programi i Pensionit me Benefit të Definuar**

- a) Bazat e përcaktimit të benefitit të pensionit. Në përgjithsi, Urdhëresa e Pensionit duhet të siguroj që benefiti i pensionit duhet të përcaktohet me metodën e llogaritjes e cila merr parasysh elementet si vijojnë:
  1. Mesatarja e rrogës së indeksuar apo rroga e pjesmarrësit , gjatë të gjitha viteve të kredituara të asaj /atij të shërbimit, e indeksuar për të përfshirë efektin e inflacionit( ndryshimet në koston e jetesës) ose të lidhura me referencat tjera të caktuara. Vlera e rrogës, duke përfshirë edhe ngritjen, nuk duhet të tejkaloj limitin e fitimeve të bazës së pensionit, të përshkruara sipas Rregullës 16 të këtyre Rregullave.

2. Shkalla e arritjes së benefitit, që nuk tejkalon dyshin, për vitet e shërbimit të kreditua, dhe
3. Benefiti i Pensionit, jo më i madh në vlerë se sa lartësia maksimale e benefitit. Në determinimin e lartësis maksimale të benefitit:
  - (i) Shkalla e benefiti të arritur nuk duhet të tejkaloj 2 për vjet të shërbimit të kredituar dhe
  - (ii) Lartësia maksimale e benefitit nuk duhet të jetë më e lartë se 80% të mesatares së rrogës së ngritur, e cila shumë mund të mos e tejkaloj vlerën e fitimit të bazës së pensionit.
- b) Benefiti maksimal mujor i pensionit. Fitimi i bazës së pensionit sikur që është paraqitur në Rregullën 16 momentalisht është limituar në 24,000 Euro për vit. Prandaj, duke zbatuar lartsin e benefitit të pensionit prej 80%, Benefiti maksimal i Pensionit është 19,200 Euro për vit, ose 1,600 Euro në muaj.
- c) “Drejtat e rezervuara (fituara) për benefitin e pensionit.” “Drejtat e fituara” janë definuar sipas Nenit 1 të Rregullores së Pensionit dhe Rregullës 12 të këtyre Rregullave. Urdhëresa e Pensionit (Akti normative i Pensionit) mund të specifikoj numrin e caktuar të viteve të akumuluar të shërbimit për pjesmarrsin që të plotsojë si kusht për ate/atë të siguroj “drejtë” parciale apo të pjesrishme të benefitit të pensionit të atij/asaj; duke siguruar se numri i viteve të akumuluar të shërbimit të siguroj “ Drejtat e fituara” të plota nuk do të tejkaloj 5 vite.
- d) Benefiti i hershëm i pensionit. Nëse përfshihet si benefit në Urdhëresën e Pensionit, vlera e pensionit për pjesmarrësin të cilët zgjidhen për tu pensionuar para moshës së pensionit është redukuar nga shkalla ose përqindja e specifikuar për qdo numër të viteve që mbeten deri në moshën 65 vjeqare.;sigurohet; në asnjë rast vlera e benefiti të pensionit nuk tejkalon Vlerën Prezente të benefiti të pensionit të përcaktuar në Urdhëresën e Pensionit dhe i determinuar si Raporti i fundit i Vlersimit Aktuarial menjëherë para datës së pensionimit të hershëm.
- e) Benefiti i Pensionit Invalidor. Nëse përfshihet si benefit në Urdhëresën e Pensionit, vlera e kualifikimit të pensionit invalidor nuk duhet të tejkaloj 70% të rrogës së indeksuar mesatare të pjesmarrsit gjatë viteve të kredituara të shërbimit dhe gjatë kualifikimit të invaliditetit të asaj/atij. Pensioni invalidor duhet të jetë i pagueshëm deri në datën më të hershme kur invaliditeti përfundon , ose në moshën 65 vjeqare ku pjesmarrësi është titulluar për pensionin e tij normal. Fondet e pensionit që ofrojnë për benefitet e pensionit invalidor duhet të sigurojnë ose ndryshe ta sigurojë ate, gjatë periodës të kualifikimit invalidor, pjesmarrësi është titulluar që të pranoj pensioni e asaj/atij invalidor dhe të gjitha kontributet e paguara për pensionin e asaj/atij.

- f) Benefiti i partnerit. Nëse pjesmarrësi që është i martuar vdes para moshës së pensionit, benefited e atij/asaj të pensionit, të barabarta së paku me 75% të pensionit të pjesmarrësit të llogaritura sikur ai/ajo të pensionohet në moshën e pensionit, bëhet benefit i pensionit të shtyer për bashkshortin e atij/asaj.
- g) Pagesa e benefiteve të pensionit. Pensionet duhet të paguhen në baza mujore të llogaritura me anë të formulës së pagesës së benefitit të definuar në Urdhresën e Pensionit. Nëse formula e pagesës së benefitit është e shprehur në total, konvertimi i saj në pagesën ekuivalente mujore të pensionit duhet të jetë në pajtim me Tabelën e Benefiteve, të përfshirë ose të bërë si pjesë e Urdhresës së Pensionit, bazuar në supozimet aktuariale.
- h) Benefitet e pensionit të shtyer. Pjesmarrësit të cilit i ndërprehet marrdhënja e punës, titullohet që të lë të Drejtat e Fituara në Fondin e Pensionit si pension i shtyer. Ky pension i shtyer është i barabartë me të Drejtat e Fituara të pjesmarrësit në benefitin e pensionit të asaj/atij në kohën e përfundimit të marrdhënjes së punës. Pagesat e pensioneve mund të fillojnë vetëm në moshën 65 vjeqare ose, në opcionin e pjesmarrësit, në arritjen e moshës së asaj/atij të lejuar për pension të hershëm. Nëse një individ i cili ka pension të shtyer vdes para fillimit të pensionit, benefitet e pensionit të shtyer do të paguhen në pajtim me dispozitat e Urdhresës duke respektuar të drejtat e pjesmarrësit në rast të vdekjes.

Nëse pjesmarrësi i cili përfundon punsimin e tij nuk është i titulluar për ndonjë pension të shtyer, akumulimi i kontributeve të Pundhënësit në emër të tij do të zbatohen si kontribute të Pundhënësit për vitin financiar për llogarinë dhe benefitin e pjesmarrësve të tjerë.

- i) Llogartija e viteve të kredituara ose të akumuluar të shërbimit. Direktivat në caktimin e viteve të kredituara ose të akumuluar të shërbimit janë si vijojnë:
  1. Bazuar në moshë minimale të pranueshmërisë së pensionit, në moshën 18 vjeqare, maksimumi i viteve të kredituara ose shërbimit të akumuluar është 46.
  2. Numri maksimal i viteve të shërbimit të kredituar ose të akumuluar nuk duhet të tejkaloj numrin e viteve që pjesmarrësi është punsuar nga pundhënësi i dhënë plus numrin e viteve të shërbimit që ai/ajo kanë shërbyer te pundhënësi i mëhershëm, varsisht prej kërkesave si:
    - (i) Perioda e viteve të kredituara të shërbimit me pundhënësin e mëhershëm mund të lejohen vetëm në rast se janë transferuar mjete të mjaftueshme në Fondin e ri të Pensionit dhe mjetet e transferuara përmbushin obligimet e benefitit të Fondi të ri të Pensionit, duke përfshirë periodat e shërbimit

që kërkohen të përfshihen për kredi si vite të akumuluar të shërbimit.

- (ii) Nëpunësi i ri, Pundhënësi i ri dhe Fondi i Pensionit pajtohen me vendimin me shkrim duke caktuar shumën e mjeteve që kërkohet të transferohet që të mbuloj vitet e shërbimit të nëpunësit të atribueshme për punsimin e asaj/atij të mëhershëm dhe përfshirja e viteve të tilla të shërbimit, varshisht prej kushteve që fondi i përmendur më lartë është pranuar nga Fondi i ri i Pensionit Brenda periodës prej 30 ditësh prej pjesmarrjes së nëpunësit të ri dhe të Drejtat e Rezervuara (të ligjshme) të të gjithë pjesmarrësve të tanishëm nuk janë të ndikuara pafavorshëm.
- (iii) Kopja e vendimit me shkrim dhe dokumenti që evidenton transferin e fondit korrespondues në Fondin e Pensionit, të përmendur në nenin 2 më lartë, dorzohet në BPK Brenda 45 ditësh të ekzekutimit të vendimit.

3. Në rats të benefitit të pensionit të vdekjes apo invaliditetit, perioda e viteve të kredituara të shërbimit duhet të përfshijë numrin e viteve prej datës së kualifikimit të invaliditetin ose vdekjes dhe datës kur pjesmarrësi arrin, ose do të arrij moshën 65 vjeqare.

4. Efekti i ri-punsimit. Pjesmarrësi i cili është ri-punsuar brenda periodës 30 ditëshe (nga i njëjti pundhënës) do të konsiderohet se ka mirmbajtur shërbim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë për qëllim të Fondit të Pensionit të Pundhënësit sponsorues nëse ka me konditat e zbatuara si vijojnë:

- (i) Drejtat e ligjshme të nëpunësit të ri-punsuar janë ende në Fondin e Pensionit si pension i shtyer, ose
- (ii) Nëse nëpunësi i ri-punsuar ka bërë transfer të të Drejtave të tija të Ligjshme në një skemë tjetër të pensionit, vlera e Drejtave të Ligjshme është transferuar dhe kthyer dhe pranuar nga Fondi i Pensionit Brenda periodës prej 30 ditësh prej datës kur pjesmarrësi është ri-punsuar.

j) Ndërprerjet në një vit të shërbimit duhet të vazhdojnë në baza proporcionale në determinimin e benefiteve të pensionit dhe kontributeve.

### **3.2 Programi i Pensioneve me Kontribut të Definuar**

- a) Bazat e përcaktimit të Benefitet të Pensionit. Në përgjithsi, Urdhëresa e Pensionit duhet të ofrojë atë benefit të pensionit që do të jetë vlera e fondeve, e llogaritur dhe determinuar në pajtim me Rregullën 7 të këtyre Rregullave, e shpërndarë në Llogaritë Individuale të Pjesmarrësve në datën e fundit të vlersimit të muajit të fundit kur pensioni ka filluar. Vlera e mjeteve në Llogarinë Individuale të pjesmarrësit përbëhet prej:
1. Kontributeve totale të bëra nga pjesmarrësi gjatë gjithë periodës së kontributeve të tij, plus
  2. Kontributet totale të bëra nga Pundhënësi në emër të pjesmarrësit gjatë gjithë periodës së kontributeve, plus
  3. Fitimet në investime të shpërndara në vlerat e përshkruara në nenin 1 dhe 2 më lartë, kosto më e vogël e arsyeshme e administrimit të pensionit.
- b) Vlera e benefiti të pensionit mujor. Fondi i Pensionit duhet të blejë një Kontratë Anuiteti prej Komapnisë së Sigurimit jetsor, në pajtim me Rregullën 11 të këtyre Rregullave. Anuiteti do të paguaj pensionet mujore. Vlera e pensioneve mujore determinohet prej:
1. Vlerës së mjeteve në Llogarinë Individuale të pjesmarrësit në datën e pensionit,
  2. Moshës së pensionerit dhe
  3. Zgjedhja e opcionit të setëlmentit.
- Rregulla 11 i adresohet pagesës së pensioneve për pjesmarrësin në Fondin e Pensionit me Kontribut të Definuar.
- c) Të Drejtat e Ligjshme (të rezervuara). Drejtat e Rezervuara janë definuar në Seksionin 1 të Rregullores së Pensionit dhe Rregullën 2 të këtyre Rregullave. Të Drejtat e Rezervuara të pjesmarrësit në pensionin me kontribut të definuar janë të barabarta me vlerën e mjeteve të shpërndara në Llogarinë Individuale të asaj/atij në datën e fundit të vlersimit.
- d) Benefiti i pensionit të hershëm. Nëse përfshihet si benefit në Urdhëresën e Pensionit, pjesmarrsi që zgjedh të pensionohet para moshës së pensionit, mundë të filloj pensionin. Vlera e mjeteve në Llogarinë Individuale të asaj/atij, që përbëjnë të Drejtat e Rezervuara të asaj/atij, prej datës së fundit të vlersimit që paraprin muajin e pensionimit të asaj/atij duhet të shfrytzohe për të blerë një Anuitet duke qenë në pajtim me Rregullën 11 të këtyre Rregullave.

- e) Benefiti i pensionit invalidor. Nëse përfshihet si benefit në Urdhëresën e Pensionit, vlera e pensionit të kualifikuar të invaliditetit nuk duhet të tejkaloj 70% të mesatares së rrogës së indeksuar ose pagës së pjesmarrsit gjatë viteve të kredituara të shërbimit të asaj/atij. Pensioni invalidor duhet të bëhet i pagueshëm deri në datën kur invaliditeti pushon ose në moshën 65 vjeqare ku pjesmarrsi titullohet për pensionin e tij normal. Fondet e Pensionit që ofrojnë benefitin e pensionit invalidor duhet të sigurojnë se gjatë periodës së kualifikimit të invaliditetit:
1. Pjesmarrsi titullohet që të pranoj pensionin e tij/asaj/ invalidor dhe
  2. Se të gjitha kontributet për llogarinë e asaj/atij për Fondin e Pensionit, gjatë periodës së kualifikimit, janë paguar.
- f) Benefiti i partnerit. Nëse pjesmarrsi që është i martuar vdes para moshës së pensionit, benefiti i pensionit i barabartë me Drejtat e asaj/atij të Rezervuara ( Bilanci i Llogarisë Individuale) prej datës së fundit të vlersimit para muajit të vdekjes lihet mënjandë si benefit i pensionit të shtyer për bashkshortin/en e tij.
- g) Benefitet e pensionit të shtyer. Pjesmarrësi punsimi i të cilit është ndërprerë , titullohet që të lë të Drejtat e tija të Rezervuara në Fondin e Pensionit si pension i shtyer. Pagesat e pensionit mund të fillojnë vetëm në moshën 65 vjeqare ose sipas opcionit të pjesmarrsit, në arritjen e moshës së asaj/atij të lejuar për pension të hershëm. Nëse individi i cili ka pension të shtyer vdes para fillimit të pensionit, benefiti i pensionit të shtyer do të paguhet në pajtim me dispozitat e Urdhëresës duke respektuar të drejtat e pjesmarrsit në rast të vdekjes së tij.

#### **Neni 4 Hyrja në Fuqi**

Kjo Rregull duhet të hyjë në fuqi më 23 tetor 2002.

---

Drejtori i Përgjithshëm